

20131062542

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË
LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13 dhe 69/13), në nenin 15 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për nevojat e mbajtjes së RUEB, Ministria në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të përpunojë të dhëna personale për anëtarët e familjeve të ekonomive bujqësore (emri dhe mbiemri, vendi dhe adresa e banimit) duke e përfshirë edhe numrin unik amë."

Paragrafët (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19) dhe (20) bëhen paragrafë (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20) dhe (21).

Pas paragrafit (21) cili bëhet paragrafi (22) shtohen dy paragraf të rinj (23) dhe (24), si vijojnë:

"(23) Në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, për rregullimin kontraktues të të drejtave dhe obligimeve për shfrytëzimin e ujit për ujitje dhe kullosave në pronësi shtetërore, të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni mund të përdoren nga ekonomitë e ujërave dhe bashkësitë e ujërave të themeluara në pajtim me Ligjin për ekonomi të ujërave dhe Ligjin për bashkësi të ujërave, si dhe nga Ndërmarrja Publike për Ekonomizim me Kullosa në pronësi shtetërore.

(24) Ministria është e obliguar që të dhënat personale nga paragrafi (3) i këtij neni t'i ruajë pesë vite pas mbarimit të nevojës për përpunimin e të dhënave personale të anëtarit të ekonomisë familjare bujqësore."

Neni 2

Në nenin 21 paragrafi (3) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "përveç kryetarëve të grupeve të përhershme nënsektoriale të cilëve mandati u është në kohëzgjatje të mandatit nga neni 23 paragrafi (7) të këtij ligji."

Neni 3

Në nenin 31 paragrafi (6) alineja 4 fjalët: "kanë në pronësi" zëvendësohen me fjalët: "disponon me".

Neni 4

Në nenin 33 paragrafi (27) ndryshohet si vijon:

"Organi kompetent për mbikëqyrje inspektuese nga ky ligj, pas regjistrimit të blerësve në Regjistër, çdo vit para fillimit të blerjes së prodhimeve bujqësore në periudhën nga 1 maji deri më 31 korrik e përcakton plotësimin e kushteve nga neni 31 të këtij ligji nga ana e blerësve të regjistruar."

Neni 5

Në nenin 36 paragrafi (2) alineja 3 fjalët: "disponojnë me " zëvendësohen me fjalët: "kanë në pronësi".

Neni 6

Në nenin 101 paragrafi (1) alineja 7 presja në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 8 shlyhet.

Në paragrafin (3) fjalët: "alineja 4" shlyhen.

Paragrafët (5) dhe (6) shlyhen.

Neni 7

Neni 101-a shlyhet.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".